



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 1711/5 prot**

**Datë 20.10.2021**

**V E N D I M**

**Nr. 785/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.10.2021 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes së ankeses së operatorit ekonomik “Eco Empire” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-04239-08-31-2021 me objekt: “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore*”, me fond limit 609,862,458.85 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
*Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 - Shkodër*

**Ankimues:** “Eco Empire” SHPK  
*Maminas, L.Karpen, Rruga e Vjetër, Z.K 2100, Nr.P 4/53/1, Durrës*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

*“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-04239-08-31-2021 me objekt: “Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore”, me fond limit 609,862,458.85 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 10.09.2021 operatori ekonomik “Eco Empire” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe elektronikisht në autoritetin kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit. Sipas autoritetit kontraktor ankesa është protokolluar në këtë institucion në datën 13.09.2021.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b)

të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 15675 prot datë 17.09.2021 me objekt: “*Informacion*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 1711/3 prot datë 22.09.2021, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, informon Komisionin e Prokurimit Publik, se nga ana e tij është kërkuar ekspertizë e jashtme për të asistuar Bashkinë Shkodër për trajtimin në mënyrë sa më profesionale të ankesës së shoqërisë “*Eco Empire*” SHPK, prandaj është shtyrë afati i shqyrtimit të ankesës sipas LPP-së.

II.5. Në datën 18.10.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1711/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër nr. 15675/1 prot., datë 13.10.2021 me objekt: “*Informacion*”. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës dhe anulimin e procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr. 15675 prot datë 17.09.2021 me objekt: “*Informacion*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 1711/3 prot datë 22.09.2021, autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër, informon Komisionin e Prokurimit Publik, se nga ana e tij është kërkuar ekspertizë e jashtme për të asistuar Bashkinë Shkodër për trajtimin në mënyrë sa më profesionale të ankesës së shoqërisë “*Eco Empire*” SHPK, prandaj është shtyrë afati i shqyrtimit të ankesës sipas LPP-së.

III.1.2. Në datën 18.10.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1711/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër nr. 15675/1 prot., datë 13.10.2021 me objekt: “*Informacion*”. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës dhe anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe*

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 15675/1 prot., datë 13.10.2021, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër e ka pranuar tërësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Gjithashtu autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër informon se: “[...] do të marrë masat e nevojshme për anulimin e procedurës së prokurimit në SPE dhe rishpalljen e saj nga fillimi, ku do të reflektohen kërkesat e paraqitura në formularin e ankesës nga ana e operatorit ekonomik “Eco Empire” SHPK.”

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Empire” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-04239-08-31-2021 me objekt: “*Shërbimi i pastrimit për Bashkinë Shkodër Zona Qendrore*”, me fond limit 609,862,458.85 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Empire” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**